

**RAPORT NGA KAMPI VEROR PËR FËMIJË ULQINI 2009**  
**Grupi 1**  
**NGA DATA 21/08-01/09/2009.**



Mbështetur dhe financuar nga **ONLUS R.BAZONI**  
Implementuar nga **HANDIKOS**

### **Hyrje:**

Sikur edhe tetë vitet e mëparshme, organizimi i kampit, struktura e fëmijëve dhe përcjellësve të tyre është bërë në mënyrë të njëjtë nga të gjitha Qendrat e RBB`së HandiKOS`it

Edhe këtë vit kemi arritur që në ekip të punëtorëve ta kemi psikologen e cila është koordinatore e aktiviteteve nëpër qendrat e HandiKOS-it, e cila ishte në cilësinë e përgjegjëses së kampit për fëmijë.

**Pjesëmarrësit – 48 persona .**

22fëmijë dhe 22 përcjellëse, si dhe

4 punëtorë nga HandiKOS-i .

**Gjinia:** 13 djem dhe 9 vajza.

**Përcjellësit:** 19 nëna

2 gjyshe

1 kujdestare.

### **Aftësitë e kufizuara të fëmijëve/Diagnozat:**

4 fëmijë me Paralizë Cerebrale

3 fëmijë me Hemiparezë

4 fëmijë me Sy Down

1 fëmijë me LCC, Bill.

1 fëmijë me Hidrocefalus

1 fëmijë me Microcephalus.

1 fëmijë me RPM.

1 fëmijë me Dëmtime Intelektuale.

1 fëmijë me Hypofrenia.

2 fëmijë me Paraparesis Spastica.

2 fëmijë me Spina Bifida .

1 fëmijë me Dystrophia Muscularis .



### **Ekipi nga HandiKOS`i si dhe përgjegjësitë e tyre :**

Taibe Morina - Psikologe dhe përgjegjëse e kampit.

Selvije Selmani - - Punëtores e rehabilitimit primar fizik.

Ilmije Hyseni - Edukatore e aktiviteteve zhvillimore/psiko-motorike .

Mejreme Aliu - Punëtores e rehabilitimit primar fizik .



**Transporti:** Është bërë nga agjencia turistike “ Arbeni Tours” ( autobus).

**VENDI:** Ulqin Hotel ,, FLORIDA”, plazhi i vogël.

Arsyeja e zgjedhjes së vendit të njëjtë që disa vite, është se ky Hotel i plotëson kushtet për fëmijët dhe aktivitetet që realizohen aty si dhe afërsia me plazhin por edhe mikpritja dhe përkrahja e pronarit të Hotelit dhe personelit. Ku edhe këtë vit ka qenë një mikpritje e shkëlqyeshme e cila është vlerësuar nga nënat dhe punëtoret e Kampit .

**Udhëtimi** – Nisja nga Prishtina është bërë në ora 21:00 me datën 21/08/2009, arritja në Ulqin në ora 08:00 me datën 22/08/09 , ndërsa kthimi është bërë me datën 01/09/09 në ora 20 : 00 , kurse arritja në Prishtinë me datën 02/09/09 në ora 07 : 30 .

**Dita e parë dhe prezantimi në mbrëmje** – Pas arritjes dhe akomodimit të fëmijëve dhe përcjellësve në Hotel si dhe pushimit të tyre, në mbrëmjen e parë është bërë prezantimi i qëllimit të kampit, orari i aktivitetëve, nga personeli i HandiKOS`it.

Po këtë mbrëmje është prezantuar fondacioni ONLUS R.BAZZONI i cili ka qenë mbështetës i kampeve që 9 vite si dhe ndihma dhe përkrahja edhe në aktivitetet e tjera të HandiKOS`it, i cili kontribut është çmuar shumë nga të gjithë pjesëmarrësit. Gjatë kësaj mbrëmje është dhënë edhe një historik i shkurtër mbi HANDIKOS`in, shërbimet që ofrohen nëpër qendrat e RBB` së për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuar si dhe aktivitetet tjera që realizohen ne HandiKOS.



Po ashtu është folur edhe për Kryetarin e ndjer z. HALIT FERIZIN i cili ishte themeluesi i parë i Organizatës së HandiKOS-it , dhe tërë jetën e tij ia ka kushtuar personave me aftësi të kufizuara duke ju ndihmuar që ata të mos rrin të mbyllur por të jenë aktiv në shoqëri . Çdoherë ka luftuar për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në mënyrë që ato të drejta të mos shkelen .



Ishte njeriu i parë i cili personat me aftësi të kufizuara të cilët ishin të mbyllur ju hapi dyert duke i aktivizuar në Qendrat e HandiKOS-it . Sot personat me aftësi të kufizuara duke e falënderuar të ndjerin z. HALIT FERIZIN janë punësuar në institucione të ndryshme dhe janë të pavarur.

Sikur edhe viteve të mëparshme, nga personeli i HandiKOS`it ishte përgatitur për çdo fëmijë nga një dhuratë për djem dhe vajza (vajzave nga një çantë me nga një kukull dhe mjete didaktike , ndërsa për djemtë nga një çantë me vetura dhe lodra dhe mjete didaktike ). Pastaj u janë shpërndarë maicat me mbishkrimin e: logon e HandiKOS`it , fotografia e të ndjerit Kryetarit të HandiKOS-it Z. HALIT FERIZIT , emri i donatorit R. BAZZONI, si dhe në to ka qenë i shtypur emri doktoreshës Julia Palao, në shenjë respekti për kontributin që ka dhënë për personat me aftësi të kufizuara në Kosovë.

Në këtë mbrëmje është bërë edhe shpërndarja e të hollave të cilat kanë qenë të planifikuara për fëmijët si shkak i kushteve të rënda ekonomike si dhe një përkrahjeje nga donatori.

### **Aktivitetet**

**Mëngjesi** – Në aktivitetet e mëngjesit fëmijët kanë qenë të ndarë në dy grupe Grupi A dhe Grupi B, ku njëri grup ka mbajtur aktivitetet e rehabilitimit fizik (fizioterapi) kurse tjetri aktivitetet psiko-motorike dhe anasjelltas.

### **Aktivitetet e rehabilitimit fizik**

**(Fizioterapisë)** – Kryesisht është punuar fizioterapi aktive dhe pasive, duke u bazuar në programin e RBB`së, që implementohet nëpër qendrat e HandiKOS`it si dhe vazhdimësinë dhe përcjelljen e këtyre aktiviteteve nga nënat dhe përcjellëset e tyre. Gjatë këtyre ditëve, nenave ju kemi referuar që të punojnë sa më shumë në

pavarësinë e fëmijëve meqenëse edhe ky kamp kishte qëllimin e njëjtë.

Duhet theksuar ushtrimet që janë bërë, ushtrimet e stimulimit mio-oral

Blendiona Mulliqit (Besian ) dhe po ashtu e kemi këshilluar nënën se si ta

ushqej vajzën e cila kishte probleme me

ngrënie dhe nëna nuk dinte si ta

ushqente . Ku për një kohë të shkurtër

vajza ka arritur përtypje më të mirë si

dhe nëna ka mësuar mënyrën se si

duhet ta ushqej vajzën më mirë , e gjithë

kjo është arritur me punën e

punëtoreve të cilat e kanë bërë në

kamp . Ky përmirësim është rregullat i

Kampit.

Po ashtu pjesë e këtyre aktiviteteve ka



qenë edhe gjimnastika grupore ku të gjitha këto ushtrime me dëshirën e nënave janë realizuar çdo mëngjes te Pishat.

**Aktivitetet Psiko-motorike**-gjatë këtyre dhjetë ditëve është bërë punë intensive me fëmijë por edhe me nënat e tyre, duke filluar nga stimulimi i tyre si dhe gjetja e mënyrave më të mira për tejkalimin e vështirësive që kanë fëmijët në jetën e tyre të përditshme. Aktivitetet që janë realizuar gjatë këtyre ditëve kanë qenë: përdorimi i lapsit, ngjyrosje, punimi me plastelin, vizatim, formimi i figurave në letrat me ngjyre, punimi i zarfeve e po ashtu gjatë seancave janë lexuar tregime të ndryshme për fëmijë nga libra të ndryshme si Pinoku , Rosaku i Vogël.



**Plazhi** – aktivitetet në plazh janë organizuar çdo ditë duke filluar nga ora 10 deri në kohën e drekës dhe pas dreke nga ora 14 deri në 17.30.

Gjatë kësaj kohe në plazh, janë zhvilluar aktivitete të ndryshme si loja Gjeje shokun , loja me balona , loja Peshku në Det, loja me topa dhe shishe , loja me rërë, noti me fëmijë , loja me litar, loja me thasë zalli etj. Po ashtu përveç aktiviteteve që kanë qenë në orar janë mbajtur edhe lojëra tjera të ndryshme si loja me top në ujë, ushtrime në ujë, noti me fëmijë dhe nënat .

Sikur viteve tjera edhe këtë vit z. Ali Kraja ka shprehur dëshirën vullnetare për shpërndarjen e krofneve të cilat u janë shpërndarë fëmijëve çdo ditë në mëngjes. Këta fëmijë për herë të parë kanë shijuar detin , secili fëmijë ka hezituuar me hy në ujë , por ata janë mësuar dhe mandej vetëm në ujë rrinin ,për secilin fëmijë ka qenë një ndjenjë e papërskrueshme.

**Udhëtimi me anije**- ndër aktivitetet e shumta që janë realizuar gjatë këtyre ditëve, ka qenë edhe udhëtimi me anije nga plazhi i vogël deri te plazhi i madh. Ky udhëtim ka qenë i veçante meqenëse asnjë nga fëmijët dhe nënat e tyre nuk kishin përjetuar një kënaqësi të tillë dhe për ta ishte një përjetim i rrallë.



Lundrimi ka qenë ndjenë shumë e veçantë, gjatë lundrimit nënat kanë kënduar, buzëqeshja në fytyrat e fëmijëve dhe kënaqësia e cila vërehej në fytyrat e nënave dhe fëmijëve ka qenë përcjellja e këtij lundrimi.

**Dalja në qytet** – Shumë nga nënat dhe fëmijët deri më tani kishin qenë të mbyllur dhe nuk kishin pasur rast që të dalin në qytetet e tyre dhe dalja në qytetin e Ulqinit me fëmijët e tyre ishte një rast që ato të fillojnë ti thyejnë kompleksët që ishin si paragjykim i shoqërisë ndaj tyre. Nënat me fëmijët e tyre sipas nevojave të tyre dilnin në qytet pa u penguar nga askush pasi u ambientuan me qytetin . Po ashtu kemi pasur edhe shëtitje të pishat ku qëndronim me orë të tëra e po ashtu atje i kemi realizuar edhe aktivitetet e fizioterapis dhe psikoterapis , pasi që ky vend njihet edhe si vend rehabilitues për probleme të ndryshme shëndetësore.

**Aktivitetet e mbrëmjes** – Gjatë mbrëmjeve janë organizuar edhe aktivitete tjera të ndryshme, si ajo e hapjes solemne, nata ku fëmijët kanë recituar, kënduar dhe vallëzuar e që për disa fëmijë ishte hera e parë që dilnin para publikut, të cilët fëmijë më parë kanë hezituat të dilnin para publikut . Por përmes aktiviteteve të mbajtura në këtë kamp ata kanë arritur të recitojnë pa problem dhe kanë qenë në gjendje me jap komente .



Po ashtu edhe nga organizimi i aktiviteteve të ndryshme nga nënat si Show, maskemball këndim nga nënat me def , vallëzime nga nënat dhe fëmijët etj. Në të gjitha këto mbrëmje është vërejtur se fëmijët kanë pasur nevojë për këto aktivitete sepse secila nga këto aktivitete ishte diçka e re e pa shijuar ndonjëherë si për fëmijët ashtu edhe për përcjellësit e tyre.

Për këto dhjetë ditë përmes këtyre aktiviteteve të zhvilluara kemi arritur që nënave t'ju largojmë stresin dhe depresionin të cilin e kanë fituar gjatë rritjes dhe edukimit të fëmijëve të tyre .

Në këtë kamp një fëmijë, Fjolla Prishtina e kishte ditëlindjen dhe të gjitha nënat u organizuan dhe i





festuan ditëlindjen Fjollës e cila ishte tejet e gëzuar e sidomos kur asaj iu përgatitë një torte nga një Ëmbëltore në Ulqin ( pronarët nga Gostivari – dhuratë ), si dhe disa dhuratave që asaj iu dhuruan atë natë nga vet nënat. Po ashtu gjatë kësaj nate nënat dhe fëmijët kanë vallëzuar dhe kanë kënduar me DEF . Jo vetëm këtë natë por edhe netëve tjera kemi organizuar ahengje me nënat duke vallëzuar dhe duke kënduar me DEF me nënat dhe fëmijët të cilët janë kënaqur shumë.

Po ashtu kishte edhe organizime tjera nga nënat dhe fëmijët e tyre si: pjesë teatrale, imitime të ndryshme etj.

**Në një rën prej netëve të pas darkës, është bërë edhe zbulimi i ekspozitës me punime nga plastelini te skanuara (ngjitura ) ne fletë të bardhë të punuara nga fëmijët, si dhe punimet e bëra me letra të ndryshme ngjyra- ngjyra, kjo ishte një punë sa interesante po aq atraktive, për të zbuluar talentin e fëmijëve dëshirën për pjesëmarrje ne aktivitet dhe njëkohësisht dëshirën për jetë e cila mendoj që ju ka munguar këtyre fëmijëve .**

#### **Ekspozita :**

Po ashtu kemi mbajtur ekspozitën me punimet të cilat i kanë punuar fëmijët gjatë kohës sa kanë qëndruar në Ulqin , si dhe çdo fëmije i janë bërë vizatime me dorë dhe ngjyra ne fytyrat e tyre që njëkohësisht i kanë bërë vet fëmijët me qëllim që edhe ata duke angazhuar mimikën e tyre t'i japin një performancë më të mirë pamjes se tyre, e po ashtu i kanë vendosur edhe Maskat të cilat ishin blerë enkas për fëmijët . Gjatë kësaj nate fëmijët kanë shfaqur edhe një pjesë teatrale me kafshë në mënyrën si ata kanë ditë mi imitu kafshët e ndryshme.



Është bërë hapja e ekspozitës me ç`rast ka pasur edhe vallëzim, këndim e recitim nga fëmijët e po ashtu edhe nga nënat e tyre.

#### **Party-**

Një natë para se të përfundonte Kampi kemi mbajtur edhe Party me nënat dhe fëmijët , ku kemi vallëzuar dhe kemi kënduar me nënat dhe fëmijët të cilët janë kënaqur shumë . Gjatë kësaj nate kemi pasur edhe mysafir nga Plazha e Madhe Drejtorin e HandiKOS-it Afrim Maliqin, disa menaxhera të qendrave të HandiKOS-it , doktoreshën dhe motrat medicinale.

Gjatë kësaj mbrëmje janë zgjedhur edhe Misat ( nënat ) si Mis Kampi, Mis Florida, eleganca etj , kjo ishte një natë e veçantë , një natë e shkëlqyeshme e cila do të mbetet gjatë në kujtimet e nënave fëmijëve dhe stafit dhe besoj që sdo të harrohet kurrë kënaqësia të cilën nënat e përjetuan gjatë kësaj nate e po ashtu edhe gjatë dhjetë ditëve qëndrimi në Kampin e Ulqinit.

**Nëna Mis Kampi me buzëqeshje tha “ O në jetë më erdhi edhe kjo mundësi që as në ëndërr nuk e kam parë “ mu zgjedh Mis ka qenë një ndjenjë e pa përshkruar për mua të cilën nuk do ta harroj kurrë në jetë . Faleminderit për të gjitha R.Bazzoni i cili na mundësoi ardhjen në Ulqin.**



**TAKIMET ME NËNAT:** Gjatë qëndrimit në kamp kemi mbajtur takime të veçanta me nënat.

Pas diskutimit të secilit rast në veçanti me nënat, sipas aftësive të kufizuara (diagnozave) të fëmijëve, me: Paralysis Cerebralis, Hemiparesis, Polio, RPM, PPB, Sy Down janë dhënë sqarime, këshilla .

Arsyeja e takimeve ishte që nënave t'u ofrohen sa më shume njohuri rreth paaftësive të fëmijëve të tyre, aftësive të fëmijëve, pavarësimit sa me të madh të fëmijëve por edhe puna që vetë nënat mund të bëjnë në përmirësimin e gjendjes së fëmijëve në shtëpi.



Diskutimet me nënat janë mbajtur pas orës 22 00 në mbrëmje , më herët nuk kemi mundur ti mbajmë sepse fëmijët kanë qenë zgjuar dhe sipas vlerësimit të psikologes këto diskutime nuk duhet të bëhen para fëmijëve sepse ndikojnë



negativisht në zhvillimin e personalitetit të fëmijës . Takimet me nënat janë realizuar në taras,ku secila nënë tregonte rreth problemeve të cilat i ka përjetuar gjatë rritjes dhe edukimit të fëmijës së vet , në takimet grupore ,por kemi pas edhe takime individuale me nënat në mënyrë që nënat të lirohen nga energjia negative të cilën e kanë përjetuar gjatë rritjes së fëmijëve të tyre, ku të gjitha i janë falënderuar shumë qendrave të HandiKOS-it të cilat ju kanë ndihmuar shumë me ushtrimet dhe këshillat të cilat ju japin nënave .

Përjetime shumë interesante na ka treguar nëna nga Peja e D.SH, pastaj ajo nga Ferizaji si dhe nëna nga Istogu të cilat pas bisedës me këto nëna ato kanë thënë që tani e ndjejnë veten shumë më të qetë .

Gjithashtu janë mbajtur edhe ligjërime mbi diagnoza të ndryshme si: Paralizen Cerebrale , Syndrom Down . Gjatë ligjëratave për PC kishte edhe diskutime të ndryshme nga ana e nënave , dua të theksoj në ligjëratën e PC fjalën e mori edhe gjyshja e Admir Gashit nga Prizreni e cila së pari e falënderoj shumë donatorin R. Bazzonin i cili na ka mundësuar me ardh në Ulqin , HandiKOS-in , dhe tregoi për ndihmën të cilën i ka ofruar HandiKOS-i me ushtrime dhe këshilla fëmija ka arritur shumë . Ajo tregoi edhe përvojën e vet që ka pasur me nipin e vet , problemet dhe vështirësitë që i ka hasur me mjekët .

Ajo ju japi një mesazh nënave duke ju thënë “ Ju jeni ato të cilat do të ndikoni në përmasimin e fëmijës suaj “, ushtrimet i bëjnë fëmijët në HandiKOS , por nëse edhe ne nuk kujdesemi që ato ushtrime ti praktikojmë në shtëpi atëherë është e kotë, sepse me 45 minuta ushtrime fëmija nuk mund të përparoj nëse këshillat e punëtoreve të HandiKOS-it nuk i aplikojmë në shtëpi . Duke ju falenderuar këshillave të cilat mi japin HandiKOS-i e të cilat i aplikoj sot nipi im është në një gjendje shumë të mirë në krahasim si ka qenë më herët .

**Kujdesi Mjekësor** – Gjatë këtyre 10 ditëve sa ishim në kamp nuk kemi pasur probleme serioze shëndetësore me fëmijë, përveç atyre më të shpeshta: temperatura,barkë qitje, dhimbje (barku, koke etj), por edhe problemet me tension të nënave. Por të gjitha këto probleme shëndetësore është përkujdesur doktoresha dhe motra medicinale me njohuritë e tyre por gjithashtu ndihma ka qenë në pajisjet mjekësore me të cilat posedonim gjatë qëndrimit në kamp. Kështu që nga doktoresha është preferuar që çdo mëngjes çdo fëmije t`u jepen vitamina C, në mënyrë që fëmijëve t`u shtohet imuniteti dhe të parandalohet çdo sëmundje apo virus.

### **Vlerësim nga psikologja**

Duke marrë parasysh kushtet dhe rrethanat në të cilën jetojnë nënat kosovare e sidomos nënat e fëmijëve me aftësi të kufizuar atëherë mund të them se në kamp

përmes takimeve grupore dhe atyre individuale të cilat i kemi mbajtur me nënat është vërejt shqetësimi i tyre që kanë për fëmijët e tyre , secila nënë ka qenë e stresuar si dhe disa prej tyre edhe me depresion të lehtë.

Përmes takimeve është vërejt se secila nënë e po ashtu edhe fëmija ka nevojë për përkrahje emocionale.

Gjatë takimeve grupore ( terapi grupore ) me nënat, ku secila prej tyre tregonte ngjarjen e jetës së vet , ato shpreheshin shumë lirshëm dhe i tregonin të gjitha problemet e tyre , po ashtu shkëmbenin mendimet dhe përvojat e tyre në mes veti lidhur me edukimin e fëmijëve të tyre . Kemi pas edhe disa nëna të cilat kanë qenë pak me komplekse por me anë të bisedave me to shpejt është arrit që edhe ato nëna ti kalojnë ato vështirësi duke i vështruar edhe nënat tjera. Gjatë takimeve grupore kemi pasur edhe gjendje prekëse emocionale ku nënat gjatë tregimit të ngjarjes së tyre fillonin të qanin, dhe njëkohësisht liroheshin nga energjia negative dhe nga stresi të cilin e kanë përjetuar ato . Në fund të bisedës në pyetjen se si po ndjehesh tash, nëna përgjigjej tani po e ndjej veten shumë më të qetë , prandaj unë mendoj që përmes këtyre bisedave kemi arritur që këto nëna ti qetësojmë emocionalisht , dhe gjithashtu tju japim këshilla për një jetë pa brenga dhe pa probleme për fëmijët e tyre , në mënyrë që këto probleme të mos i bartin te fëmijët e tyre .

Po ashtu gjatë këtyre takimeve kemi mbajtur edhe takime individuale me nënat të cilat kanë qenë në gjendje më të rëndë emocionale, dua të theksoj bisedën individuale me nënën Z. H. E cila ishte në një gjendje të rëndë emocionale , ajo kishte fëmijën e vetëm Y. H me aftësi të kufizuara dhe ishte shumë e shqetësuar dhe në gjendje paniku, për gjendjen e fëmijës së saj , ajo tërë kohën ofshante dhe pyeste se a ka shërim fëmija i saj . Pas shumë bisedave individuale dhe dhënies së këshillave me këtë nënë është arritur që nëna të qetësohet dhe filloj ta ndjej veten më qetë në aspektin emocional . Unë mendoj që kjo ka nevojë edhe për vizitë te psikiatri për terapi , unë kam biseduar edhe me nënën dhe e kam referuar që ta bëjë një vizitë te psikiatri dhe ajo më ka premtuar që do ta bëjë .

Unë jam munduar ta bind gjatë bisedave që kemi arritur ti realizojmë por te rastet e rënda psikologjike atëherë duhet të intervenohet edhe me terapi .

Sa i përket fëmijëve ne të gjithë e dimë se fëmijët janë të lidhur emocionalisht me prindërit e sidomos me nënat e tyre , edhe në kamp të gjithë fëmijët kanë qenë të lidhur me nënat e tyre por ne përmes aktiviteteve të cilat i kemi mbajtur kemi arritur që për disa orë ti largojmë fëmijët nga nënat duke luajtur me ta dhe duke i socializuar fëmijët në mes veti , ku të gjithë fëmijët shpejt janë adaptuar me ambientin dhe aktivitetet që i kemi organizuar. Kjo ka qenë rezultat i aktiviteteve të cilat janë mbajtur në Kamp .

Unë çdoherë ju kam thënë që të gjithë ne duhet ta pranojmë jetën ashtu si na vjen , të mundohemi të krijojmë kushte sa më të mira në aspektin emocional për fëmijët tanë pa marrë parasysh kushtet në të cilat jetojmë . Duhet të mundohemi që përmes aktiviteteve dhe ushtrimeve me fëmijë ti pavarsojm për një të ardhme me të mirë .

### **Rezultatet-**

Te gjithë fëmijët pas përpjekjeve me kënaqësi e kanë pranuar ujin dhe socializmin me fëmijët tjetër. Shumë prej tyre filluan të ushqehen vetë, të vishen

dhe zhvishen vetë, e deri te recitimet para tjerëve për të cilat deri më tani kishin hezituar shumë.

Nëna nga Ferizaji tregon se fëmija i saj i ka përmirësuar lëvizjet tani i ka më të lira se më herët. Nëna nga Mitrovica tregon se vajza e saj Eneida ka arrit me kuptuar se ku po shkon dhe ku po kthehet d.m.th e vëren ndërrimin e ambientit gjë që më herët nuk e ka vërejt.

Nëna nga Gjakova tregon se djali i saj Albani ka fillu ti shqiptoj disa fjalë të reja të cilat më herët nuk i ka fol si Dada, Ama, nëna.

Lumbardhi nga Prizreni ka filluar me fol më shumë ,ka filluar mi thirr në emra njerëzit që më herët nuk fol , vetëm fjalën baba e ka thënë.

Defrim Limaj nga Malisheva në Kamp ka filluar ta përmirësoj komunikimin përmes ushtrimeve e po ashtu edhe lëvizjet e duarve i ka përmirësuar .Përmes këshillave që janë dhënë djali ka filluar të kujdeset më shumë për veten dhe të pavarësohet .

Po ashtu duhet theksuar se është hera e parë që në këtë kamp kemi pas prezent një vajzë pa përkujdesje prindërore ( pa prindër ) që është në strehim familjar të një familje e cila ka qenë me kujdestaren në kamp.

Ka qenë një ndjenjë e papërshtueshme si dhe hera e parë për atë fëmijë që shkon në deti , dhe që socializohet me aq shumë fëmijë, ku në Kamp asaj vajze i është festuar edhe ditëlindja .

Një befasi nga fëmija nga Istogu Endrit Blakaj me Spina Bifida , nëna e tij tregon që djali nuk ka pasur ndjeshmëri fare në këmbë , tani pas pesë dite në Kamp djali ka filluar ta ndjej dhimbjen në këmbë gjë që më herët nuk e ka pasur ndjeshmërinë në këmbë .

Nëna ndjehet shumë e lumtur dhe e gëzuar që përmes këtij Kampi fëmija i saj ka arritur suksese të mëdha duke ju falënderuar HandiKOS-it dhe donatorit R.Bazzonit i cili ju bëri të mundur ardhjen në Ulqin që më herët ajo nuk ka qenë kurrë në pushime në det kjo ishte hera e parë në deti.

Të gjitha këto rezultate pa dyshim ju takojnë Donatorëve; HandiKOS-it dhe stafit i cili punon me neve në Kamp.

Për të gjitha nënat kjo ka qenë hera e parë në pushime në deti.

### **Përshtypjet nga nënat dhe fëmijët :**

- Përshtypjet e veçante **R.Bazzoni** nga fëmijët me aftësi të kufizuara te Kosovës.
- Falenderim i madh i takon **R. Bazzonit** i cili na mundësoi që fëmijët tanë të kënaqen në deti.
- Emri **Bazzoni** do te jete gjithmonë ne kujtesën tone.
- Ditët e Ulqinit janë ditë të pa përshkruara për mua dhe djalin tim.



- Përshëndetje e veçantë për Bazzonin i cili na realizoj një ëndërr të cilën ne nuk kemi mundur ta realizojmë.
- Kemi pas çastet më të lumtura të jetës sonë të cilat nuk do të harrohen për tërë jetën.
- Këto çaste nuk do të harrohen kurrë Ju falënderoj nga zemra



**TAIBE MORINA  
SELVIJE SELMANI  
ILMIJE HYSANI  
MEJREME ALIU  
2009.**

**PRISHTINË**